



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2021:014495

Datë: 24.03.2024

Numri i dokumentit: 05494740

P.nr.333A/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PRISHTIË – DEGA FUSHË KOSOVË - Departamenti i Përgjithshëm Penal, sipas Gjyqtares Laura Hoti Statovci, në lëndën penale të akuzuarit L. J. nga F. K., i akuzuar për veprën penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.2817/20 të datë 27.01.2021, në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 20.03.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit Blerim Igrishta dhe i akuzuari L. J., me datë 20.03.2024 mori dhe publikisht shpalli ndërsa me datë 23.03.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri L. J. i biri i I..... dhe nëna S....., e gjinisë K....., i lindur me në P....., me vendbanim në F..... K..... Rr. “.....” Objekti “E... L...” Kati .. nr..., me numër personal, të dhëna këto të vërtetuara nga dokumenti i letërnjoftimit të lëshuar nga MPB, ka të kryer shkollën fillore, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Ekziston dyshimi i bazuar mirë se me datë 18.05.2020 rreth orës 18:30 në Fushë Kosovë pa autorizim kishte poseduar narkotikë substancë psikotrope apo analoge në atë mënyrë që gjatë patrullimit në terren zyrtarët policorë kishin ndaluar veturën e tipit S.... me targa me dy persona ku gjatë kontrollës tek i pandehuri kishin gjetur dhe sekuestruar tri paketime të vogla me substancë të dyshuar narkotike të mbështjella me foli metalike e që pas ekspertizës është vërtetuar të jetë e llojit Kanabis (marihuanë) që përmban tetrahidrokanabinol (TCH) pesha neto 1.53 gram.

- *Me këtë ka kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge nga neni 269 par. 2 të KPRK-së.*

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 43, 48, 69, 70, 71, të KPRK-së neneve 240, 241, 242 par. 1 dhe 358, 359, 360, 364 të KPPRK-së, të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT DHE DENIM ME GJOBË

- I. Dënim me burg në kohëzgjatje prej tre (3) muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej një (1) viti nëse i akuzuari gjatë kësaj periudhe nuk kryen vepër të re penale si dhe
- II. Dënim me gjobë në shumën prej 200.00 (dyqind) Euro të cilin dënim i pandehuri obligohet që ta paguaj në afat prej 30 ditëve nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi
- III. Nëse i pandehuri dënimin me gjobë nuk e paguan në afat të caktuar më lartë, atëherë gjykata këtë dënim do ta zëvendësoj me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditësh, duke llogaritur një ditë burgim me 20 (njëzetë) euro të gjobës.
- IV. Konfiskohet substanca narkotike e llojit marihuanë, me peshë të përgjithshme prej 1.53 gram dhe urdhërohet asgjësimi i substancës nga Policia e Kosovës në bashkëpunim me Prokurorinë.
- V. Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës gjyqësore të paguaj shumën prej 20 (njëzet) në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shumën prej 20 (njëzet) euro në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzë PP.II.nr.2817/20 të datë 27.01.2021, ndaj të akzuarit L. J. për shkak të dyshimit të bazuar mire se ka kryer veprën penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së, 06/L-074).

Gjykata, në këtë çështje penale juridike ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 20.03.2024, në prani të Prokurorit të Shtetit Blerim Igrishta dhe të pandehurit L. J. ku i njëjti u njoftuan me të drejtat e tij, me aktakuzën dhe provat kundër tij. Pas kësaj prokurori i shtetit lexoj aktakuzën kundër të pandehurit.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i pandehuri u deklarua se e pranojnë fajësinë për veprën penale për të cilat akuzohet sipas aktakuzës.

Pas deklarimit të pandehurit dhe mendimit të prokurorit se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, Gjykata konstatoj se i pandehuri ka pranuar fajësinë në mënyrë vullnetare dhe pa asnjë presion, i pandehuri është i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 248 par. 1 të KPRK-së janë përmbushur. Ashtu që gjykata aprovon deklarimin për pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 357 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 242 par. 6 lidhur me par. 2 të KPRK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të akzuarit se e pranojnë fajësinë në kuptim të nenit 242 par. 6 të KPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me faktet e ofruara ne shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit L. J. qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së, 06/L-074).

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se i akuzuari e ka kryer veprën me dashje, ndërsa gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese ne kuptim të nenit 70 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të akuzuarin, gjykata ka vlerësuar faktin se i akuzuari ka treguar sjellje korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësor duke pranuar fajësinë, duke u ndier i përgjegjshëm për veprimet e tij dhe duke shpreh keqardhje për veprën që e ka kryer, po ashtu i njëjti nuk ka qenë i dënuar me parë. Të gjitha këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese ne dobi të akuzuarit, ndërsa si rrethana rënduese Gjykata nuk gjeti.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, Gjykata ne kuptim të nenit 43 dhe 48 të KPRK-së të akuzuarin e gjykoj si ne dispozitiv të këtij aktgjykimit, me të cilin do të arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Gjykata ka ardhur ne përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është ne përputhje me shkallen e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit ne pengimin e të pandehurit ne kryerjen e veprave penale ne të ardhmen veçanërisht llojin e njëjte të veprës penale, por ai do të ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale ne përputhje me nenin 38 të KPPRK-së.

Duke u bazuar ne nenin 449 par. 2 pika 2.6 dhe 452 par.1 të KPPRK-së si dhe në bazë të nenit 36 par.3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit nr.08/L-109, Gjykata ka vendosur për shpenzimet e procedurës penale në shumën e përgjithshme prej 40 Euro.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 364 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA FUSHË KOSOVË,
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL
P.nr.333A/23 datë 22.03.2024

Gjyqtarja e vetme Gjykuese

Laura Hoti Statovci

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.